



**BULETINI MUJOR I
SEMUNDSHMERISE
INFEKTIVE**

(Pasqyra 14 Sh)

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

JANAR, 2019

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Të dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin Janar janë të dhënat e raportuara nga të 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit janar 2019 zënë 25.34 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 215.31/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide dhe Shigelozes për muajin janar 2019 me 3 raste me Salmonelozës jotifoide (0.18/10.000 banore) të konfirmuara dhe 13 raste Shigeloze (0.78/10.000 banore). Ndërkohe që në nivel kombëtar toksikoinfeksionet alimentare paraqesin një incidencë 3.43/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Elbasan dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare.


Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin Janar, 2019 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Janar 2019	Incidenca Janar 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	3	0.11
Shigeloze (Disenteri bacilare)	13	0.46
Dizenteri amebike	0	
Toksikoinfeksione alimentare	96	3.43
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	5917	211.31
Semundje diarreike ne total	6029	215.31


2. Sëmundjet e EPI

2.1. Fruthi

Gjatë muajit janar 2019 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 130 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 65 raste. Nga këto 39 (60%) e rasteve i përkasin rrethit të Tiranës. 40 % e rasteve të konfirmuara i përkasin kryesisht grupmoshës < 2 vjeç (26 raste).



Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Janar 2019.



Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Janar 2018

Ne muajin Janar te nje viti me pare, 2018 u raportuan ne total 120 raste prej te vileve 63 u konfirmuan . Nga keto 50 raste ose 79% i perkasin rrethit te Tiranës. 67% ose 42 raste i perkasin grupmoshes nen 2 vjec.

Siç shihet ne krahasim për te njëjtën periudhë me një vit me pare, numri i rasteve është pothuajse i njëjte dhe grupmosha < 2 vjeç vazhdon te jete grupmosha me e prekur për shkak edhe te mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës te mëparshëm te tyre ne shërbimin pediatrik QSUT. Te gjitha rastet janë konfirmuar ne Laboratorin e Virologjisë, ne ISHP.

2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit janar 2019 janë raportuar 12 raste me Tuberkuloz pulmonar, 6 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar dhe 18 raste me Tuberkuloz miliar. Rastet e raportuara me tuberkuloz pulmonar janë përkatësisht 8 nga Tirana dhe nga një rast kane raportuar Vlora, Mirëdita, Lezha dhe Laçi. Rastet janë te grup-moshave te ndryshme nga 20-65 + vjeç.

Rastet e raportuara me Tuberkuloz ekstrapulmonar janë përkatësisht dy nga Tirana, dy nga Korça dhe nga një rast kane raportuar Lushnja dhe Gramshi.

Ndërsa me Tuberkuloz miliar janë raportuar 18 raste qe vine përkatësisht, 10 nga Tirana, dy nga Korça dhe nga një rast kane raportuar Vlora, Gramshi, Laçi, Lezha, Lushnja dhe Mirëdita.

3. Zoonozat

Gjatë muajit janar me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHIP-te dhe DSHP-te janë raportuar ne nivel vendi:

- një rast, mashkull i grupmoshës 30-34 vjeç i konfirmuar nga rrethi i Pogradecit me bruceloze.
- një rast mashkull i grupmoshës 35-39 vjeç i konfirmuar me antraks nga rrethi i Vlorës.
- dy raste te konfirmuara me Leishmanie viscerale te grupmoshës < 1 vjeç nga rrethi i Shkodres.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Janar 2019 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Janar 2019	Incidenca Janar 2018 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	1	0.04
Brucelozë	1	0.04
Leptospirozë	3	0.11
Leishmaniaza viscerale	2	0.07
Leishmaniaza kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit janar 2019 janë raportuar ne total 10 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.36/100.000 banore) nga te cilat 3 raste janë Hepatite virale të paspecifikuar, 1 rast Hepatit viral C i konfirmuar nga Tirana dhe 6 raste Hepatit virale B te konfirmuara.

Ne lidhje me HBV, 6 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga rrethi i Matit (2 raste), Mallakastër, Laç, Tirane dhe Kuçove përkatësisht nga një rast.

Rastet me Hepatit viral B i përkasin grupmoshës se rritur përkatësisht : nga 1 rast grupmosha 35-39 vjeç, 40-44 vjeç, 50-54 vjeç dhe 65 + vjeç. Ndërsa 2 raste i përkasin grupmoshës 45-49 vjeç.

Rasti me hepatit C i përket grupmoshës se rritur 40-44 vjeç.

5. Meningoencefalite

Gjate muajit janar 2019 janë raportuar ne total 2 raste meningite bakteriale meningokoksike te konfirmuara nga Tirana dhe Elbasani, te grupmoshave 25-29 vjeç. Janë raportuar katër raste te konfirmuara me meningite bakteriale jo meningokoksike përkatësisht te grupmoshave < 1 vjeç (2 raste), 1-4 vjeç (1 rast) dhe 65+ vjeç (1 rast). Rastet janë raportuar tre nga Tirana dhe një nga rrethi i Matit.

6. HIV/AIDS

Gjate muajit Janar 2019 janë kryer gjithsej 57 ekzaminime për HIV, prej te cilave 12 raste kane rezultuar HIV pozitiv. Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 8 raste janë meshkuj dhe 4 janë femra. Shpërndarja gjeografike e rasteve qe kane rezultuar HIV pozitive, tregon se 8 prej këtyre rasteve janë me vendbanim ne **Tirane**, 3 ne **Elbasan** dhe 1 rast ne Shkodër. Grupmosha e rasteve pozitive varion nga 26 vjeç deri ne 51 vjeç, me një predominance te grupmoshës 30-34vjeç. Rastet pozitive kane ardhur kryesisht nga klinikat (6 nga Infektivi dhe një rast nga Spitali i Sëmundjeve te Mushkërive), një rast nga VCT Tirane, një nga Banka e gjakut dhe një nga Spitali Amerikan. Dy raste janë testuar pasi partneret e tyre kane rezultuar pozitiv.

7. Gripi

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se ne muajin Janar 2019 aktiviteti i tyre paraqet rritje ndërsa aktivitetit i gripit ishte i përhapur dhe me intensitet mesatar, me mbizotërim të qarkullimit të virusit të tipit A, nëntipi A/H1 pdm09.

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI